

Rregullat e Procedures Arbitrazhit
Arbitrazhi dhe Ndermjetesimi Tregtar

1. Interpretimi

- 1.1 Ne keto rregulla, termat e meposhtem do e kene kuptimin e meposhtem:
- a. "Qendra" do te thote Qendra Shqiptare Ndermjetesimit dhe Arbitrazhit Tregtar;
 - b. "Trupi i Arbitrave" do te thote nje arbiter i vetem ose nje panel arbitrash;
 - c. "Marreveshje Arbitrazhi" do te thote nje marreveshje e shkruar ndermjet dy ose me shume paleve, qe bien dakort qe cdo mosmarreveshje, kundershtim ose pretendim qe lind mes paleve, t'ja paraqesin per zgjidhje arbitrazhit;
 - d. "Dite Biznesi" do te thote nga e hena deri te premten, duke perjashtuar ditet e pushimeve zyrtare ose statutore;
 - e. "Drejtor Ekzekutiv" do te thote Drejtori Ekzekutiv i Qendres;
 - f. "Pale" do te thote nje pale ose palet ne nje Marreveshje Arbitrazhi;
 - g. "Perfaquesues" do te thote nje perfaquesues i autorizuar i nje pale;
 - h. "Rregulla" do te thote Rregullat e Arbitrazhit te Qendres, ne fuqi ne kohen e fillimit te arbitrazhit.
- 1.2 Referanca tek keto Rregulla ne nje kontrate ose ne ndonje menyre tjeter, konsiderohet te jete nje reference per te gjitha pjeset e Rregullave, ne qofte se referencia nuk eshte ne menyre specifike per nje ose me shume pjesa te caktuara.
- 1.3 Aty ku eshte e pershtatshme ne keto Rregulla, fjalet ne njejes do te perfshijne shumesin dhe fjalet ne gjinine mashkulore do te perfshijne femeroren.

2. Zbatimi

- 2.1 Keto Rregulla dhe ndonje amendament i tyre ne fuqi ne daten e fillimit te nje arbitrazhi, objekt i ndryshimeve te tilla ashtu sic palet mund te bien dakort me shkrim mes tyre, do te zbatohen ne te gjitha arbitrazhet e zhvilluara nga nje arbiter i emeruar nga Qendra dhe do te konsiderohen te jene pjesa e Marreveshjes se Arbirazhit ku palet kane parashikuar arbitrazhin sipas ketyre Rregullave.
- 2.2 Ne rastin kur ndonje nga parashikimet e ketyre Rregullave eshte ne kundershtim me ndonje ligj te zbatueshem, veprimin e te cilit palet nuk mund ta shmangin, parashikimi i atij ligji do te kete perparezi.
- 2.3 Palet, ne cdo kohe, me miratim te perbashket, mund ti ndryshojne keto Rregulla.

3. Fshehtesa e procesit te Arbitrazhit

- 3.1 Objekt i parashikimeve te nenit 3.2 me poshte, te gjitha arbitrazhet e zhvilluara sipas ketyre Rregullave, jane te fshehta dhe konfidenciale. Palet dhe Perfaquesuesit e tyre mund te marrin pjesa ne arbitrazh. Te githe personat e tjere mund te marrin pjesa vetem me miratimin e Paleve dhe te Trupit te Arbitrave.
- 3.2 Pervec aq sa eshte e nevojshme ne lidhje me nje padi ne gjykate, per arbitrazhin ose ne lidhje me nje veprim per zbatimin e nje vendimi, asnjë informacion ne lidhje me ekzistencen e nje arbitrazhi nuk mund te behet i njohur ne menyre te njeanshme nga njera Pale ndonje pale te trete, ne qofte se kjo nuk kerkohet nga ligji ose nga ndonje organ rregullues kompetent, dhe ne kete rast vetem:
- 3.2.1 Duke bere te njohur jo me shume se cfare kerkohet ligjerisht, dhe

3.2.2 Duke i dhene, Trupit te Arbitrave dhe Pales tjeter, ne qofte se publikimi behet gjate zhvillimit te arbitrazhit, ose vetem Pales tjeter ne qofte se publikimi behet pas perfundimit te arbitrazhit, detajet e publikimit dhe nje shpjegim te arsyeve per te cilat eshte bere publikimi.

4. Njoftimi, Llogaritja e Afateve Kohore

4.1 Ne perputhje me qellimin e ketyre Rregullave, cdo njoftim, duke perfshire nje lajmerim, komunikim ose propozim, konsiderohet qe eshte dhene, ne qofte se i eshte dorezuar fizikisht marresit, ose ne qofte se eshte derguar ne rezidencen e tij te zakonshme, vendin e biznesit ose adresen postare, ose ne qofte se asnje nga keto nuk mund te gjenden pas kryerjes se kerkimeve te arsyeshme, ne rezidencen e fundit te njohur te marresit. Njoftimi konsiderohet qe eshte marre ne diten qe ai eshte dorezuar.

4.2 Per qellime te llogaritjes se nje periudhe kohe sipas ketyre Rregullave, nje periudhe e tille kohe do te filloje te ece ne diten pasardhese te dites kur eshte marre njoftimi, lajmerimi ose propozimi. Ne qofte se dita e fundit e nje periudhe te tille eshte pushim zyrtar ose nuk eshte dite pune ne vendin e rezidences ose te biznesit te marresit, dita e fundit do te konsiderohet qe te jetet dita e pare e punes qe vjen me pas. Pushimet zyrtare ose ditet qe nuk jane dite pune dhe qe bien gjate ecjes se periudhes se kohes, perfshihen ne llogaritjen e periudhes.

ARBITRI

5. Numri i Arbitrave

5.1 Palet jane te lira te percaktojne numrin e arbitrave ne Marreveshjen e tyre te Arbitrazhit, ose me vone me shkrim.

5.2 Ne qofte se Palet nuk arrijne te bien dakort per numrin e arbitrave ne Marreveshjen e tyre te Arbitrazhit, ose me vone me shkrim, Qendra do te emeroje nje arbiter te vetem nga Lista e tij e Arbitrave. Ne qofte se palet nuk bien dakort, Qendra ka te drejte te caktoje nje Panel Arbitrash per raste qe jane te pershatshme per nje panel arbitrash.

6. Emerimi i Arbitrit

6.1 Autoriteti emerues te cilit i referohen keto Rregulla, eshte Qendra.

6.2 Palet mund te ndjekin proceduren e emerimit sic percaktohet ne Marreveshjen e tyre te Arbitrazhit, ose sic mund te bien dakort me vone me shkrim.

6.3 Ne qofte se palet nuk bien dakort per nje procedure emerimi ne Marreveshjen e Arbitrazhit, ose me vone me shkrim, do te jete Qendra qe do te emeroje Arbitrin.

7. Kerkesa per Largim te Arbitrave nga Procesi

7.1 Kur me nje person diskutohet ne lidhje me nje emerim te mundshem te tij si nje arbiter, ai duhet te beje te njohur cdo rrethane qe mund te ngreje dyshime te justifikuara per paanesine ose pavarsine e tij. Nje arbiter, nga koha e emerimit te tij dhe gjate procesit te arbitrazhit, duhet pa vonese te beje te njohur paleve cdo rrethane te tille, ne qofte se ato nuk jane informuar tashme per to nga ai.

7.2 Ndaj nje arbitri mund te behet kerkesa per largim nga procesi vetem ne qofte se egzistojne rrethana qe ngrejne dyshime te justifikuara per paanesine ose pavarsine e tij, ose ne qofte se ai nuk zoteron kualifikimin e rene dakort nga palet. Nje pale mund te kerkoje largimin nga procesi te nje arbitri te emeruar nga ajo, ose ne emerimin e te cilit ajo ka marre pjese, vetem per arsyen per te cilat ajo eshte vene ne dijeni pasi eshte bere emerimi.

8. Procedura per Largimin e Arbitrit

8.1 Nje pale qe ka nder mend te kerkoje largimin e arbitrit, do ta dergoje njoftimin per kerkesen e saj per largimin e arbitrit, brenda 15 ditesh nga marria e njoftimit per emerimin e

arbitrit ndaj te cilit kerkohet largimi, ose brenda 15 ditesh pasi rrrethana e permendur ne Rregullin 7, behet e njobur per ate pale.

8.2 Pala ose palet e tjera ne mosmarreveshje dhe antaret e tjere te Trupit te Arbitral ravedo te njoftojne per kerkesen per largim dhe arbitrin te cilit i drejtohet. Njoftimi duhet te jetet me shkrim dhe duhet te paraqese arsyet per kerkesen per largim.

8.3 Kur ndaj nje arbitri eshte bere kerkese per largim nga njera pale, pala tjeter mund te bjere dakort me kerkesen per largim. Arbitri, pas kerkeses per largim, mund te terhiqet nga detyra e tij. Ne asnjerin nga rastet, nje fakt i tille nuk do te nenkuuptojethote pranimin te vlefshmerise se arsyeve te kerkeses per largim. Ne te dy rastet, procedura e parashikuar ne Rregullin 6, do te perdoret plotesisht per emerimin e arbitrit zevendesues, edhe nese gjate procesit te emerimit te arbitrit ndaj te cilit kerkohet largimi, njera pale nuk ka arritur te perdore te drejten e saj per te emeruar ose per te marre pjese ne emerim.

8.4 Ne qofte se pala tjeter nuk bie dakort me kerkesen per largimin e arbitrit dhe arbitri ndaj te cilit kerkohet largimi nuk terhiqet, Drejtori Ekzekutiv i Qendresarbitri do te marre vendim ne lidhje per kerkesen per largim. (Duhet te diskutohet pasi nuk jam dakord qe Drejtroi qe kryen funksione ekzekutivo-administrative te merret me largimin e Arbitrit)

8.5 Ne qofte se kerkesa per largimin e arbitrit miratohet, nje arbiter zevendesues do te emerohet ose zgjidhet ne perputhje me procedurat e aplikuara per emerimin ose zgjedhjen e nje arbitri sic parashikohet ne Rregullen 6.

9. Zevendesimi i nje Arbitri

9.1 Ne rast te vdekjes ose terheqjes se nje arbitri gjate zhvillimit te procedurave te arbitrazhit, nje arbiter zevendesues do te emerohet ose zgjidhet, ne perputhje me procedurat e parashikuara per kete ne Rregullen 6.

9.2 Ne rast se nje arbiter deshton ne kryerjen e detyres ose ne rast te nje pamundesie *de jure* ose *de facto* te kryerjes se funksioneve te tij, do te zbatohet e njejt procedure si ne rastin e kerkeses se largimit dhe zevendesimit te nje arbitri, sic parashikohet ne artikujt paraardhes.

10. Perseritja e Degjimit ne Rastin e Zevendesimit te nje Arbitri

Ne qofte se sipas ketyre Rregullave, zevendesohet arbitri i vetem ose kryetari i Trupit Arbitral cdo degjim i bere me perpara do te perseritet; ne qofte se zevendesohet ndonje arbiter tjeter, degjimet e meparshme mund te perseriten sipas vleresimit te Trupit te Arbitrave.

PROCEDURA E PERGJITHSHME

11. Perfaqesimi

Palet mund te perfaqesohen nga persona te tjere, sipas zgjedhjes se tyre. Emrat dhe adresat e ketyre personave duhet ti komunikohen me shkrim pales tjeter dhe arbitrave.

12. Njoftimi i Arbitrazhit

12.1 Pala qe fillon procedurat e arbitrazhit (qe ketu me poshte do te quhet "paditesi") do ti dergoje nje

njoftim per arbitrazhin pales tjeter (qe ketu me poshte do te quhet "i padituri") dhe Qendres.

12.2 Procedurat e arbitrazhit do te konsiderohen qe kane filluar ne diten ne te cilin Qendra merr njoftimin per arbitrazh.

12.3 Nje njoftim per arbitrazh do te permbate informacionin e meposhtem:

12.3.1 Nje kerkese qe mosmarreveshja ti referohet arbitrazhit;

12.3.2 Emrat dhe adresat e paleve;

12.3.3 Nje referim ne klauzolen e arbitrazhit ose ne Marreveshjen e vecane te Arbitrazhit qe kerkohet te aplikohet;

12.3.4 Natyren e per gjithshme te padise;

12.3.5 Pretendimi dhe demi qe kerkohet te shperblehet.

13. Seanca Proceduriale

13.1 Trupi i Arbitrave mund te organizoje nje seance proceduriale ne cdo kohe qe ai e konsideron te pershtatshme per tu zhvilluar, ne perputhje me programin e arbitrazhit, per zgjidhjen e ceshtjeve

proceduriale dhe per caktimin e programit kohor. Nje program seance proceduriale mund te perfshije nje identifikim dhe sqarim te ceshtjeve ne mosmarreveshje.

13.2 Seanca proceduriale mund te zhvillohet edhe nepermjet konferences telefonike.

13.3 Trupi i Arbitrave do te mbaje shenim cdo marreveshje ose urdher te dhene ne ndonje seance proceduriale dhe brenda 7 ditesh nga ky takim do ti dergoje nje kopje te ketyre sejçiles nga palet.

14. Vendi i Arbitrazhit

Ne qofte se palet nuk kane rene dakort per vendin ku do te zhvillohet arbitrazhi, ky vend do te percaktohet nga Trupi I Arbitrave, duke mbajtur parasysh rrethanat e arbitrazhit.

15. Gjuha

15.1 Ne qofte se nuk ka marreveshje mes paleve apo ne Marreveshjen e Arbitrazhit ose ne nje marreveshje tjeter te mevoneshme nuk eshte parashikuar gjuha apo gjuhet qe do te perdoren gjate procedimeve, do te jete Trupi i Arbitrave ai qe do te percaktoje gjuhën ose gjuhet qe do te perdoren gjate ketyre procedimeve.

15.2 Trupi i Arbitrave mund te urdheroje qe ndonje dokument i aneksuar kerkeses se paditesit ose pergjigjies se te paditurit dhe cdo dokument suplementar ose shtese, e paraqitur gjate zhvillimit te procedimeve, i paraqitur ne gjuhën origjinale, te shoqerohet nga nje perkthim ne gjuhën ose gjuhet per te cilat palet kane rene dakort ose qe jane percaktuar nga Trupi i Arbitrave.

16. Padia e Paditesit

16.1 Ne qofte se padia e paditesit nuk permahet ne njoftimin per arbitrazhin, brenda nje periudhe kohe te percaktuar nga Trupi I Arbitrave, paditesi do ti komunikojte padine e tij me shkrim te paditurit dhe sejcilit prej arbitrave. Nje kopje e Marreveshjes se Arbitrazhit ne qofte se nuk permahet ne kontrate, do ti aneksohet asaj.

16.2 Padia duhet te permbaje hollesite e meposhtme:

16.2.1 Emrat dhe adresat e paleve;

16.2.2 Nje paraqitje te fakeve qe mbeshtesin padine;

16.2.3 Ceshtjet ne diskutim;

16.2.4 Pretendimi dhe demin qe kerkohet te .shperblehet

Paditesi mund ti bashkangjese padise se tij te gjitha dokumentat qe ai i konsideron te rendesishem ose

mund te shtoje nje referece per dokumentat ose deshmite e tjera qe ai do te paraqese.

17. Pergjigjia e te Paditurit

17.1 Brenda nje periudhe kohe qe do te percaktohet nga Trupi i Arbitrave i padituri do ti komunikojte pergjigjien e tij me shkrim paditesit dhe sejcilit prej arbitrave.

17.2 Pergjigjia e te paditurit do tu pergjigjet te gjitha hollesive te paragrafeve 2.b, c dhe d te padise se paditesit (Rregulli 16). I padituri mund ti bashkangjese si aneks pergjigjies se tij, dokumentat ne te cilat ai mbeshtet mbrojtjen e tij ose mund te shtoje nje reference per dokumentat ose deshmitë e tjera qe ai do te paraqese.

17.3 Ne pergjigjien e te paditurit, ose ne nje faze te mevonshme gjate procedimeve arbitrale, ne qofte se Trupi i Arbitrave vendos qe, bazuar ne rrethanat, vonesa eshte e justifikueshme, i padituri mund te beje kunderpadi te ngritur ne baze te te njejtës kontrate, ose te mbeshtetur ne nje padi qe eshte ngritur mbi te njejtën kontrate me qellimin e procedures.

17.4 Parashikimet e Rregulles 16, paragrafi 2, do te aplikohen per nje kunderpadi dhe nje padi te mbeshtetur ne te per qellim fillimi.

18. Amendamentet per Padine e Pergjigjien e te Paditurit

Gjate zhvillimit te procedimeve te arbitrazhit, sejcila prej paleve mund ti amendoje ose te plotesoje padine ose per gjigjen ndaj saj, ne qofte se Trupi i Arbitrave nuk e konsideron te papershtatshme lejimin e amendamenteve te tilla ne lidhje me vonesen ne berjen e tyre ose me paragjykimin e pales tjeter ose ndonje rrethane tjeter. Megjithate, nje padi mund te mos amendohet ne menyre te tille qe padia e amenduar te dale jashte qellimit te klauzoles se arbitrazhit ose Marreveshjes se vecante te Arbitrazhit.

19. Pretendimet per Juridiksionin e Trupit te Arbitrave

19.1 Trupi i Arbitrave do te kete autoritetin te vendose per objekzionet ne lidhje me juridiksionin e tij, duke perfshire ndonje objekcion ne lidhje me egzistencen ose vlefshmerine e klauzoles se arbitrazhit ose te Marreveshjes se vecante te Arbitrazhit.

19.2 Trupi i Arbitrave do te kete autoritetin te vendose per egzistencen ose vlefshmerine e kontrates, pjese e se ciles eshte klauzola e arbitrazhit. Per qellimin e ketyre Rregullave, nje klauzole arbitrazhi qe eshte pjese e nje kontrate dhe qe parashikon arbitrazhin sipas ketyre Rregullave, do te trajtohet si nje marreveshje e pavarur nga termat e tjere te kontrates. Nje vendim i Trupit te Arbitrave qe kontrata eshte e pavlefshme, nuk prek *ipso jure* vlefshmerine e klauzoles se arbitrazhit.

19.3 Pretendimi qe Trupi i Arbitrave nuk ka juridikcion, duhet te behet jo me vone se per gjigjia e te paditurit, ose ne lidhje me nje kunderpadi, ne per gjigjje te kunderpadise.

19.4 Ne per gjithesi, Trupi i Arbitrave mund te vendose per nje pretendim ne lidhje me juridiksionin e tij, si nje ceshtje paraprake. Megjithate, Trupi I Arbitrave mund te procedoje me arbirazhin dhe te vendose per nje pretendim te tille ne vendimin e tij perfundimtar.

20. Paraqitura me shkrim e Deklarimeve te Mevonshme

Trupi i Arbitrave duhet te vendose cfare deklarimesh te tjera te shkruara, pervec padise dhe per gjigjies se te paditurit, do te kerkohen nga palet ose mund te paraqiten prej tyre dhe duhet te caktoje periudhen e kohes per komunikimin e ketyre deklarimeve.

21. Afatet Kohore

Afatet kohore te fiksuara nga Trupi i Arbitrave per komunikimin e deklarimeve te shkruara (duke perfshire padine dhe per gjigjen e te paditurit) nuk duhet te kalojne 45 dite. Megjithate, Trupi i Arbitrave mund ta zgjase kete afat, ne qofte se ai konklodon se kjo zgjatje eshte e justifikuar.

22. Mocionet

Cdo pale mund te beje nje mocion para Trupit te Arbitrave ne cdo kohe, deri ne daten e degjimit, per urdherat ne lidhje me proceduren, deshmite, dokumentat dhe hetimet para degjimit te arbitrazhit. Ne vartesi te marreveshjes mes paleve, e cila do te mbizoteroje, Trupi i Arbitrave do te kete i vetem autoritetin e caktimit te procesit te ndonje degjimi te vecante.

23. Deshmite

23.1 Cdo pale do te kete barren e provimit te fakteve mbi te cilet mbeshtetet padia ose mbrojtja.
23.2 Trupi i Arbitrave mundet, ne qofte se ai e konsideron te pershatashme, ti kerkoste nje pale qe ti jape Trupit te Arbitrave dhe pales tjeter, brenda nje afati kohor sic do ta vendose Trupi i Arbitrave, nje permblehdje te dokumentave dhe te deshmive te tjera, te cilat ajo pale ka per qellim ti paraqese per te mbeshtetur faktet ne diskutim, te percaktuara ne padi ose ne per gjigjen e te paditurit.

23.3 Ne cdo kohe gjate procedimeve te arbitrazhit, Trupi i Arbitrave mund tu kerkoste paleve te paraqesin dokumenta, demonstrime ose deshmi te tjera, brenda nje afati kohor sic do ta vendose Trupi i Arbitrave.

24. Seanca Degjimore

24.1 Ne rast te degjimit te deshmive gojore, Trupi i Arbitrave do ju beje paleve njoftim paraprak ne nje kohe te pershatashme, per daten, kohen dhe vendin.

24.2 Ne qofte se duhen degjuar deshmitare, te pakten 15 dite perpara seances degjimore, sejcilat pale do ti komunikojte Trupit te Arbitrave dhe pales tjeter, emrat dhe adresat e deshmitareve qe ka nder mend te paraqese, subjektin rreth te cilit dhe gjuhen ne te cilen ky deshmitar do te jape deshmine e tij.

24.3 Trupi i Arbitrave do te organizoje perkthimin e deklarimeve gojore te bera gjate seancave degjimore dhe per regjistrimin e deshmive, ne qofte se konsiderohet e nevojshme nga Trupi i

Arbitrave per rrethanat e rastit, ose ne qofte se palet kane rene dakort dhe ja kane komunikuar kete marreveleshje Trupit te Arbitrave te pakten 15 dite para seances degimore.

24.4 Seancat Degimore do te behen me dyer te mbyllura, ne qofte se palet nuk kane rene dakort ndryshe. Trupi i Arbitrave mund te kerkoje largimin e ndonje deshmitari ose deshmitareve gjate deshmise se deshmitareve te tjere. Trupi i Arbitrave eshte i llore te percaktoje menyren ne te cilen do te pyeten deshmitaret.

24.5 Deshmite e deshmitareve mund te paraqiten gjithashtu ne formen e deklarimeve notieriale te shkruara, te firmosur prej tyre.

24.6 Trupi i Arbitrave duhet te percaktoje pranueshmerine, rendesine, materialitetin dhe peshen e deshmive te paraqitura.

25. Marrja e Masave per Sigurimin e Padise

25.1 Me kerkesen e sejçiles nga palet, Trupi i Arbitrave mund te vendose marrjen e masave per sigurimin e padise qe ajo i konsideron te nevojshme ne lidhje me ceshtjen ne mosmarreveshje, duke perfshire masat per konservimin e objekteve qe formojne subjektin e ceshtjes se mosmareveshjes, te tilla si urdherin per depozitimin e tyre tek nje person i trete ose shitjen e materialeve qe nuk mund te ruhen.

25.2 Keto masa per sigurimin e padise mund te merren ne formen e nje vendimi te perkohshem. Trupi i Arbitrave ka te drejte te kerkoje garanci monetare apo pasurore per marrjen e masave te tilla.

25.3 Kerkesa per marrjen e masave per sigurimin e padise qe i eshte adresuar nga ndonjera nga palet nje autoriteti gjyqesor, nuk do te konsiderohet qe eshte ne mosperputhje me marreveshjen e arbitrazhit, ose si nje heqje dore nga kjo marreveshje.

26. Ekspertet

26.1 Sejcila prej paleve mund te paraqese deshmi te eksperteve. Trupi i Arbitrave mund te jape urdhera, ne qofte se e konsideron te pershtatshme, ne lidhje me paraqitjen dhe shkembimin e raporteve te shkruara te ndonje eksperti te marre nga nje pale.

26.2 Trupi i Arbitrave mund te emeroje nje apo me shume eksperte per ti raportuar atij me shkrim, per ceshtje specifike qe duhen percaktuar nga Trupi i Arbitrave. Nje kopje e termave te references te ekspertit, te percaktuara nga Trupi i Arbitrave, do ti komunikohet paleve.

26.3 Palet do ti japin ekspertit cdo informacion te rendesishem ose do te pregatisin per inspektim nga ana e tij, cdo dokument ose material qe ka lidhje me ceshtjen, qe ai mund t'ju kerkoje atyre. Ndonje mosmarreveshje ndermjet nje pale dhe ekspertit ne lidhje me rendesine e informacionit materialeve te kerkuar, do ti referohet Trupit te Arbitrave per vendim.

26.4 Pas marrjes se raportit te ekspertit, Trupi i Arbitrave do ti jape kopje te tij paleve, te cilave do ju jepet mundesa per te shprehur me shkrim, opinionet e tyre per reportin. Pala do te kete te drejten per te ekzaminuar ndonje dokument ne te cilin eshte mbeshtetur eksperti ne reportin e tij.

26.5 Me kerkesen e sejçiles nga palet, eksperti, pas dorezimit te raportit, mund te degjohet gjate seances se degjimit, ku palet do te kene mundesine te jene prezent dhe te pyesin ekspertin. Ne kete seance degjimi, sejcila nga palet mund te paraqese deshmi te ekspertit ne menyre qe te deshmoje per ceshtjet ne diskutim. Parashikimet e Rregulles 23 do te aplikohen ne keto procedime.

27. Mosplotesimi

27.1 Ne qofte se brenda afatit kohor te caktuar nga Trupi i Arbitrave, paditesi nuk ka arritur te komunikoje padine e tij, pa treguar nje shkak te arsyeshem per kete mosveprim, Trupi i Arbitrave do te nxjerre nje urdher per perfundimin e procedimit arbitral. Ne qofte se brenda afatit kohor te caktuar nga Trupi i Arbitrave, i padituri nuk arrin te komunikoje per gjigjen e tij, pa treguar nje shkak te arsyeshem per kete mosveprim, Trupi i Arbitrave do te urdheroje qe procedimi te vazhdoje.

27.2 Ne qofte se nje nga palet, e njoftuar ne perputhje me keto Rregulla, nuk paraqitet ne seancen e degjimit, pa treguar nje shkak te arsyeshem per kete mosveprim, Trupi i Arbitrave mund te procedoje me arbitrazhin.

27.3 Ne qofte se nje nga palet, te ciles i kerkojet sipas rregullave te preqatise deshmi dokumentare, nuk arrin ta beje brenda afatit kohor te caktuar, pa treguar nje shkak te arsyeshem per kete mosveprim, Trupi i Arbitrave mund te marre nje vendim perfundimtar duke u bazuar deshmite e paraqitura perpara tij.

28. Mbyllja e Seances Degjimore

28.1 Trupi i Arbitrave mund ti kerkoje paleve ne qofte se ato kane prova te metejshme per te ofruar, ose deshmitare per tu degjuar, ose pohime per te bere dhe ne qofte se nuk ka, mund ta deklarojne te mbyllur seancen degjimore.

28.2 Trupi i Arbitrave mundet, ne qofte se ai e konsideron te nevojshme ne prani te rrrethanave te jashtzakonshme, te vendose me nje mocion te tij ose pas aplikimit te ndonjeres nga palet, te rihape seancen degjimore ne cdo kohe perpara se te jete marre vendimi perfundimtar.

29. Heqja Dore nga Rregullat

Nje pale qe e di qe ndonje nga parashikimet ose kerkesat e ketyre Rregullave nuk jane zbatuar dhe vazhdon te procedoje me arbitrazhin pa paraqitur menjehere kundershtimin e tij per kete moszbatim, do te konsiderohet qe ka hequr dore nga e drejta e tij per te kundershtuar.

VENDIMI

30. Vendimet

30.1 Kur ka me shume se nje arbiter, cdo vendim perfundimtar ose vendime te tjera te Trupit te Arbitrave, do te merren me shumicen e arbitrave.

30.2 Ne rastin kur ka probleme me proceduren, kur nuk arrihet shumica ose kur Trupi i Arbitrave e autorizon, kryetari i Trupit te Arbitrave mund te vendose sic mendon ai, objekt i rishikimit nga Trupi i Arbitrave, ne qofte se do te kete rishikim.

31. Forma dhe Fuqia e Vendimit Perfundimtar

31.1 Pervec marrjes se vendimit perfundimar, Trupi i Arbitrave mund te marre dhe vendime te perkoohshme, interlokutore ose te pjesshme.

31.2 Vendimi duhet bere me shkrim dhe do te jete perfundimtar dhe i detyrueshem per palet. Palet marrin persiper te zbatojne vendimin pa vonese.

31.3 Trupi i Arbitrave duhet te paraqese arsyet ne te cilat eshte bazuar vendimi.

31.4 Vendimi duhet te nenshkruhet nga arbitrat dhe duhet te permbate daten kur eshte bere, vendin ku eshte bere dhe vendimin qe eshte marre. Kur nje arbiter nuk arrin te nenshkruaje, vendimi duhet te paraqese arsyen e mungeses se nenshkrimit.

31.5 Vendimi mund te behet publik vetem pas miratimit te te dy paleve.

31.6 Kopjet e vendimit te nenshkruara nga arbitrat duhet tu komunikohen paleve nga Trupi i Arbitrave.

32. Ligji i Aplikueshem

Trupi i Arbitrave do te aplikoje ligjin sic percaktohet ne statutin qe rregullon arbitrazhin ne Republiken e Shqiperise.

33. Zgjidhja ose Arsyet e tjera per Perfundimin

33.1 Ne qofte se perpara se te jete marre vendimi perfundimtar, palet bien dakort per zgjidhjen e mosmarreveshjes, Trupi i Arbitrave ose do te nxjerre nje urdher per perfundimin e procedimeve te arbitrazhit, ose, ne qofte se kerkohet nga te dyja palet, do ta rregjistroje zgjidhjen ne formen e nje vendimi arbitrazhi ne termat e rene dakort. Trupi i Arbitrave nuk eshte i detyruar te jape arsyet e nje vendimi te tille.

33.2 Ne qofte se perpara se te jete marre vendimi perfundimtar, vazhdimi i procedimeve te arbitrazhit behet i panevojshem ose i pamundur per ndonje arsy qe nuk eshte permendur ne paragrafin 33.1, Trupi i Arbitrave do te informoje palet per qellimin e tij per nxjerjen e nje urdheri per perfundimin e procedimeve. Trupi i Arbitrave do te kete fuqine per nxjerrjen e nje urdheri te tille, ne qofte se ndonje nga palet nuk nxjerr arsyte te justifikueshme per ta kundershtuar.

33.3 Kopje te urdherit per perfundimin e procedimeve te arbitrazhit ose vendimi perfundimtar i arbitrazhit sipas termave te rene dakort, i nenshkuar nga arbitrat, duhet ti komunikohet paleve nga Trupi i Arbitrave.

34. Interpretimi i Vendimit

34.1 Brenda 30 ditesh nga marrja e vendimit, sejcila prej paleve, duke njoftuar dhe palen tjeter, mund ti kerkoste Trupit te Arbitrave qe te jape interpretimin e tij per vendimin. 34.2 Interpretimi duhet dhene me shkrim brenda 45 diteve nga marrja e kerkeses.

Interpretimi do te formoje nje pjese te vendimit.

35. Korigjimi i Vendimit

35.1 Brenda 30 ditesh pas marrjes se vendimit, sejcila prej paleve, duke njoftuar dhe palen tjeter, mund ti kerkoste Trupit te Arbitrave te korigjoje ndonje gabim ne hartimin e vendimit,

ndonje gabim llogaritje ose tipografik, ose ndonje gabim tjeter te nje natyre te ngjashme.
Trupi i Arbitrave mundet, brenda 30 diteve pas komunikimit te vendimit,

te beje korigjime te tilla me inisiativen e tij.
 35.2 Keto korigjime duhen bere me shkrim.

36. Vendimi Shtese

36.1 Brenda 30 diteve pas marrjes se vendimit, sejcila prej paleve, duke njoftuar dhe palen tjeter, mund ti kerkoje Trupi i Arbitrave qe te beje nje vendim shtese, sipas padise se paraqitur ne procedimet e arbitrazhit, por qe eshte lene pa u perfshire ne vendim.

36.2 Ne qofte se Trupi i Arbitrave e konsideron kerkesen per nje vendim shtese te justifikueshme dhe konsideron qe plotesimi mund te ratifikohet pa seanca degjimi ose deshmi te tjera, ai duhet ta plotesoje vendimin e tij brenda 60 diteve pas marrjes se kerkeses.

SHPENZIMET

37. Shpenzimet

37.1 Trupi i Arbitrave, ne vendimin e tij perfundimtar, do te caktoje shpenzimet e arbitrazhit. Termi "shpenzime" do te perfshire vetem:

37.1.1 Tarifat e Trupit te Arbitrave qe do te percaktohen ne menyre te vecante per cdo arbiter dhe do te caktohen nga vete Trupi i Arbitrave ne perputhje me Tabelen e Tarifave te Qendres Shqiptare te Ndermjetesimit dhe Arbitrazhit Tregtar;

37.1.2 Shpenzimet e udhetimit dhe shpenzime te tjera te kryera nga arbitrat;

37.1.3 Tarifat e eksperteve dhe asistenca te tjera te kerkuara nga Trupi i Arbitrave;

37.1.4 Shpenzimet e udhetimit dhe shpenzime te tjera te deshmitareve, ne ate mase qe keto shpenzime jane aprovuar nga Trupi i Arbitrave;

37.1.5 Tarifat e perfaqesimit ligjor dhe asistences te pales se fituese, ne qofte se keto shpenzime jane kerkuar gjate procedimeve te arbitrazhit dhe vetem per nje vlere te ketyre kostove, qe Trupi i Arbitrave do te percaktoje qe eshte e arsyeshme;

38. Kush i Paguan Shpenzimet

38.1 Pervec sa parashikohet ne paragrafin 2, shpenzimet e arbitrazhit, ne parim, do te mbulohen nga pala e humbur. Megjithate, Trupi i Arbitrave mund ta ndaje sejcilen nga keto shpenzime ndermjet paleve ne qofte se ai percakton se se kjo ndarje eshte e arsyeshme, duke marre ne konsiderate rr Ethanat e rastit.

38.2 Ne lidhje me shpenzimet e perfaqesimit ligjor, Trupi i Arbitrave, duke marre ne konsiderate rr Ethanat e rastit, do te jete e lire te percaktoje cila pale do ti mbuloje keto shpenzime ose mund ti ndaje keto shpenzime ndermjet paleve, ne qofte se ai vendos qe kjo ndarje eshte e arsyeshme.

38.3 Kur Trupi i Arbitrave nxjerr nje urdher per perfundimin e procedimeve te arbitrazhit,

ose merr nje vendim me termat qe eshte rene dakort, ai do te percaktoje shpenzimet qe i atribuohen arbitrazhit, ne tekstin e ketij urdheri ose vendimi.

38.4 Asnje tarife shtese nuk mund te ngarkohet nga Trupi i Arbitrave, per interpretimin, korigjimin ose plotesimin e vendimit te tij perfundimtar, sipas Rregullave 35 deri 37.

39. Depozitimi i Shpenzimeve

- 39.1 Trupi i Arbitrave, me formimin e tij, mund ti kerkoje sejciles pale, qe te depozitoje nje shume te barabarte, si nje parapagim per shpenzimet te referuara ne nenet 37.1.1, 37.1.2 dhe 37.1.3.
- 39.2 Gjate zhvillimit te procedimeve te arbitrazhit, Trupi i Arbitrave mund te kerkoje depozite suplementare nga palet.
- 39.3 Ne qofte se depozitat e kerkuara nuk paguhen te plota brenda 30 ditesh pas marrjes se kerkeses, Trupi i Arbitrave do ti informoje per kete palet ne menyre qe njera ose tjetra te mund te beje pagesen e kerkuar. Ne qofte se kjo pagese nuk behet, Trupi i Arbitrave mund te urdheroje pezullimin ose perfundimin e procedimeve te arbitrazhit.

39.4 Pas marrjes se vendimit perfundimtar, Trupi i Arbitrave do tu beje paleve llogarite e depozitave te marra dhe do ju ktheje atyre ndonje shume te pashpenzuar.

SOURCE: www.aryme.com